



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSA TË OFRUARA NGA ORGANIZATA PËR TË
DREJTËN PUBLIKE EVROPIANE (EPLO)**

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, njofton mbi programin e bursave pranë Organizatës për të Drejtën Publike Evropiane (EPLO), që u drejtohet studentëve që dëshirojnë të studiojnë në programin e arsimit të lartë, përkatësisht "Shkolla Evropiane e Drejtësisë dhe Qeverisjes", e themeluar në vitin 2016. Qëllimi i këtij Universiteti Ndërkombëtar është të edukojë një brez të rinjve, në të gjithë botën, në kuptimin më të mirë të Institucioneve Evropiane, në të bërit biznes me Evropën dhe në promovimin e interesave të tyre kombëtare brenda kontekstit të Brukselit.

Shkolla Evropiane e Drejtësisë dhe Qeverisjes mbështetet nga një rrjet profesorësh të njohur, universitete prestigjioze, institucione kërkimore dhe organizata të tjera. Shkolla ofron programe universitare dhe pasuniversitare, si dhe diploma kërkimore, në gjuhën angleze, në fushat e së drejtës evropiane dhe qeverisjes ndërkombëtare, dhe mirëpret studentë të të gjitha kombësive.

Këtë vit, EPLO/ELGS dëshiron të mirëpresë studentë nga Shqipëria për t'u bashkuar me programet e saj akademike duke ofruar deri në 5 bursa të plota për programet e nivelit universitar dhe pasuniversitar. Bursa e pjesshme do të jetë gjithashtu e disponueshme sipas kërkesës.

Më tepër informacion mbi bursat jepet në adresën elektronike: www.elgs.eu